

A B C D E F G H I J K L M N O P Q R R R R S S S S T T T T U U V X X H Y Z Z H .

○ ○
Për nivelin
e dytë

Muhamet Ahmeti-Meris
Luzhë Çulaj
Besë Luzhë
Xhevat Sylja

HISTORIA DHE TROJET SHQIPTARËT



EMRI DHE MARRËMIMI _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

VENDI _____

SHTETI _____



Këtë libër a gjeni edhe në versionin elektronik dhe mund ta shkarkoni nga uebfaqja e MASHIT të Kosovës <https://www.mashit-gov.net>

duk gjini

Muhamet Ahmeti-Metis, Lush Culaj,
Besa Luzha, Xhevat Syla

SHQIPTARËT HISTORIA DHE TROJET

Fletore tematike
për nivelin e dytë

duk^agjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis , Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues/e të këtij teksti:

Muhamet Ahmeti-Metis, Lush Culaj, Besa Luzha, Xhevat Syla

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**


PËRMBAJTJA

HYRJE	4-5
1. ILIRIA DHE ILIRËT	6-7
2. JETA NË ILIRI	8-9
3. ARTI DHE KULTURA ILIRE	10-11
4. ILIRËT DHE PERANDORIA ROMAKE	12-13
5. SHQIPTARËT DHE PERANDORIA BIZANTINE	14-15
6. ARTI DHE KULTURA SHQIPTARE NË BIZANT	16-17
7. SHQIPTARËT DHE PERANDORIA OSMANE	18
8. LUFTËRAT E SKËNDERBEUT PËR LIRI	19-21
9. PËRPJEKJET PËR RUAJTJEN E GJUHËS DHE TË KULTURËS GJATË SUNDIMIT OSMAN.....	24-25
10. LIDHJA E PRIZRENIT-NGJARJE E RËNDËSISHME KOMBËTARE....	26-27
11. RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE-FIGURA TË SHQUARA	28-29
12. ARTET NË RILINDJEN KOMBËTARE	30-31
13. KRIJIMI I SHTETIT SHQIPTAR	32-33
14. PERIUDHAT PAS PAVARËSISË.....	34-35
15. SHQIPTARËT SOT	36-37
16. SHQIPËRIA.....	38-39
17. KOSOVA	40-41
18. SHQIPTARËT NË MAQEDONI.....	42-43
19. DIASPORA SHQIPTARE	44-45
20. ARTI DHE KULTURA SHQIPTARE SOT	46-47

HYRJE

Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe njëri ndër popujt më të lashtë të Evropës.

Ata jetojnë në Shqipëri, Kosovë dhe në trojet e tjera të tyre në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbi dhe në Greqi. Shqiptarët jetojnë edhe në shumë vende të tjera të botës, ku kanë emigruar për arsye të ndryshme. Kudo që jetojnë, ata kanë të përbashkët origjinën, gjuhën, kulturën dhe historinë.



Harta e Evropës Juglindore

Ja si quhen shqiptarët në disa gjuhë botërore:

	POPULLI	GJUHA
Anglisht:	Albanians	Albanian
Gjermanisht:	Albaner	Albanisch
Frengjisht:	Albanais	Albanais
Italisht:	Albanesi	Albanese
Greqisht:	Alvani	Alvanika
Spanjisht:	Albaneses	Albanès
Kroatisht dhe serbisht:	Albania	Albanci
Turqisht	Arnaut	Arnautce



*Varëse bronzi
në Kolonjë*

Aktivitete:


1. Bisedoni në klasë se në cilat vende të botës jetojnë shqiptarët! Gjeni disa shtete në hartën e Evropës Juglindore ku jetojnë shqiptarët dhe emërtoni ato!
2. Shkruani në tabelën më lart si quhen shqiptarët edhe në disa gjuhë të tjera!
3. Kërkoni në internet të dhëna të tjera për shqiptarët!

1. ILIRIA DHE ILIRËT

Ilirët janë njëri ndër popujt më të vjetër që kanë jetuar në Evropë.

Vendi i ilirëve, Iliria, shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Në veri kufizohet me lumenjtë Sava dhe Danubi, kurse në jug kufizohet me Greqinë antike dhe me Detin Jon. Në perëndim lidhet me Detin Adriatik, kurse në lindje me lumin Morava. Vendet fqinje të Ilirisë ishin Greqia antike, Thrakia (në lindje) dhe Maqedonia antike (në juglindje).

Vendbanimet më të njohura ilire janë: Scodra (Shkodra), Risan afër Kotorit të sotëm në Mal të Zi, Lisus (Lezha), Albanopolis (Fushë-Krujë), Epidamnus-Dyrr(h)achium (Durrës), Naissus (Nishi), Ulpiana afër Prishtinës, Scupi (Shkupi i sotëm) etj.



Shtrirja e fiseve ilire



Pikturë me pamje gjuetie në fshatin Tren (Bilisht)



Durrësi antik në ditët e sotme

Ilirët, si edhe popujt e tjerë të lashtë, lidheshin në fise. Disa nga këto fise u bashkuan në mbretëri ilire. Mbreti i parë i një fisi ilir quhej Hyll (yll). Mbretër të tjerë të dalluar ishin: Bardhyli i dardaneve, Pirro i Epirit, Agroni dhe Genti të ardianëve etj. E njohur ishte edhe Mbretëresha Teutë, gruaja e mbretit Agron.

Shumë nga emrat e fiseve ilire sot përdoren nga shqiptarët për emra fëmijësh, p.sh. Ardian, Liburn, Taulant, Dardan, Enkela etj.



Mbretëresha Teutë



Monedha floriri me portretet e Agronit dhe të Teutës



Mbreti Gent



Mbreti Pirro



Mbreti Bardhyl i dardanëve

Statujë ilire nga bronzi e shek. V-VI p.e.s e gjetur në zonën e Shkodrës. Kjo statujë ruhet në Muzeun e Luvrit në Paris.




Aktivite:

1. Puno një kurorë mbretërie sipas imagjinatës tënde! Provo të vizatosh si janë dukur rrobat e mbretit dhe të mbretëreshës ilire!
2. Bëje një listë me emra për djem dhe vajza, bazuar në fiset dhe në vendbanimet ilire!
3. Kërko në libra dhe në internet më shumë të dhëna për ilirët! Prezanto rezultatet në klasë!


2. JETA NË ILIRI

Jeta në Iliri ishte interesante dhe me plot veprimtari. Ilirët shquheshin për shkathhtësi luftarake, për gjueti, për peshkim, për ndërtim anijesh dhe për tregti.

Ata merreshin me bujqësi e blegtori. Punonin tokën dhe mbillnin drithra, pemë e perime. Kultivonin ullirin dhe fruta të shumta. rritnin dele, derra, qej e kuaj. P.sh., është shumë i njohur qeni i Sharrit. Ilirët kultivonin dhe përdornin bimë shëruese, si lulja Iris dhe Gentiana Lutea, e cila mori emrin sipas mbretit Ilir Genti.



Shigjetari dardan



Ushtari ilir



Lulja Iris



Lulja Gentiana Lutea



Qeni i Sharrit

Ilirët jetonin në fshatra dhe në qytete. Qytetet ilire ishin të ndërtuara me gurë dhe kishin mure të larta. Ato kishin edhe teatro të hapura ku organizoheshin aktivitete kulturore. Një ndër teatrot më të bukur ishte ai në Butrint, afër qytetit të sotëm të Sarandës në Shqipëri.



Shkodra antike

Aktivitete:

1. Bisedoni si kanë jetuar ilirët! Me çfarë punësh janë marrë ata?
2. Përshkruaj, sipas imagjinatës tënde, një ditë nga jeta e një vajze 11 vjeçare në kohën e Ilirisë!
3. Si ishin përgatitur fëmijët për jetën e tyre? Kush dhe si i përgatiste ata?
4. Mësoni më tepër për vendbanimet ilire nga librat, të dhënat në internet etj.!

HISTORIA E EM- RAVE

(Fragment)

Në nekropolin e vjetër të qytetit të Durrësit u gjet një pllakë e bardhë guri, ku ishte gdhendur me daltë një emër. Bardhi dhe Teuta, vëlla e motër, që e kanë shtëpinë pranë muzeut arkeologjik, sapo morën vesh për zbulimin e kësaj pllake me emër të lashtë, shkuan për ta parë.

Bardhi është në klasën e tetë, kurse Teuta në klasën e gjashtë. Ata përpiqen të lexojnë sa më shumë për historinë e popullit shqiptar. Vijnë shpesh edhe në muze, ku shohin zbulimet e reja arkeologjike. Në pushimet e verës ata u kanë ndihmuar edhe arkeologëve gjatë gërmimeve në kodrën e qytetit, ku dolën në dritë punishtet artistike të ilirëve, që prodhonin statuja të vogla prej balte të pjekur, enë, maska teatri, gurë mozaiku me ngjyra të ndryshme, tabela balte me mbishkrime të përdorura si kronika e faqe librash të lashtë.

Ata mësuan shumë gjëra nga arkeologët. Zunë miqësi veçanërisht me arkeologun e ri Arben Zeka. Edhe arkeologu u lidh ngushtë me fëmijët.

Në portikun e muzeut Bardhi dhe Teuta e panë Arben Zekën të përkulur mbi pllakën e gurit, të cilën po e fshinte me furçë plot kujdes. Ç'është emër i lashtë ishte gdhendur në pllakë?

Arkeologu i ri i përshëndeti fëmijët e u tregoi gërmat e skalitura.

- Një emër ilir, - tha Arbeni, - Dardan. Është hera e parë që zbulohet në nëntokën e qytetit tonë ky emër.

Bardhi me Teutën e dinin se deri tani ishin zbuluar disa qindra shtylla e pllaka me emra ilirë. Ato ishin dëshmi e rëndësishme e gjuhës së lashtë ilire, vazhdimi i së cilës është gjuha e sotme shqipe.



Mozaiiku "Bukuroshja e Durrësit"

Moikom ZEQQ
(Nga libri "Kalorësit dardanë")


3. ARTI DHE KULTURA ILIRE

Iliria kishte pasuri të shumta tokësore e nëntokësore. Nga nëntoka nxirreshin minerale të çmueshme si hekuri, bakri, ari e argjendi.


Ilirët dalloheshin si mjeshtër të zejeve të ndryshme. Nga metalet punonin vegla pune, armë, monedha, stoli, gjilpëra, varëse, vathë, bylyzykë e zbukurime të tjera. Ata punonin edhe figura dhe vazo prej balte.



Armë ilire



Stoli ilire



Monedha Ilire

Shumë nga këto vepra sot ruhen në muzeumet tona. Një vepër e rëndësishme e shek. V p.e.s. , “**Vrapuesja nga Prizreni**”, ruhet në Muzeun Britanik.

Disa gjetje të lashta tregojnë se ilirët përdornin vegla të ndryshme muzikore si fyej, cingla, zilka etj. Nuk dihet saktë si janë quajtur në ato kohë këto vegla muzikore, por me to të parët tanë shoqëronin këngët, vallet dhe ceremonitë e tjera. Këtë e dëshmojnë pikturat dhe skulpturat e lashta me pamje vallëtarësh e këngëtarësh.



Vrapuesja nga Prizreni

Nga druri ilirët ndërtonin anije të shpejta, të cilat njiheshin me emrin “Liburnia”. Me këto anije, ilirët lundronin përtej brigjeve të Adriatikut dhe të Jonit. Ilirët besonin në jetën pas vdekjes. Ata besonin në shumë zotëra. Adhuronin Diellin si lloj perëndie dhe gjarprin si roje të shtëpisë.



Modeli i anijes
“Liburnia me gjarpër”

Në Iliri kishte mjeshtër të shquar të gdhendjes në gur dhe në mermer. Në këtë kohë u zhvillua skulptura dhe lloje të tjera të krijimtarisë figurative. Apollonia dhe Durrahu (Durrësi) u bënë qendrat më të rëndësishme të artit në Iliri. Ilirët, po ashtu, kanë zhvilluar edhe pikturën, duke zburuar objekte të ndryshme, sidomos me mozaikë. Mozaiku më i hershëm është ai i Durrësit i shekullit IV p.e.r. Ky mozaik është i punuar me gurë zalli shumëngjyrësh, ka vlera të rralla artistike dhe quhet “Bukuroshja e Durrësit”.



Mburoja ilire (simboli i diellit)



Hyjnesha Dardane në fron (Dea Dardanica)



Koka e skulpturës
Hyjnesha Dea e Butrintit



Mozaiku në pagëzimoren e
Butrintit

Aktivitete:

1. Pyetni prindërit dhe kërkoni në libra ose në internet më shumë informata për veprat e artit në kohën e Ilirisë (skulptura, gjëmadha të qyteteve të vjetra etj)!
2. Kur të shkoni në Shqipëri ose në Kosovë, vizitoni muzeumet për të parë nga afër dëshmitë, gjetjet, zburimet e veglat nga koha e Ilirisë!
3. A ka në vendin ku jetoni vendbanime të tilla nga periudha antike? Bisedoni me shokët dhe shoqet e klasës dhe me mësuesit tuaj!
4. Bëni një mozaik ose skulptura të vogla me motive ilire me materiale të ndryshme (letër, kokrra orizi, plastelinë etj)!
5. Bisedoni me mësuesin/en dhe me prindërit për simbolet ilire; diellin dhe gjarprin!

4. ILIRËT DHË PERANDORIA ROMAKE

Gjatë kohës së mbretit Agron dhe mbretëreshës Teutë, Iliria u bë mbretëri e fuqishme. Disa qytete të saj bregdetare ishin porte të rëndësishme për tregti. Iliria kishte edhe ushtri detare dhe tokësore, me të cilat mbrohej nga pushtuesit e huaj. Këtë forcim të shtetit ilir Perandoria Romake nuk e shihte me sy të mirë. Pas disa luftërave iliro-romake, Perandoria Romake pushtoi trojet ilire gjatë shekujve II-I para erës së re.

Pas pushtimit romak, Iliria u shndërrua në provincë romake me emrin “Illyricum”. Zhvillimi i mëtejshëm i Ilirisë u ndikua edhe nga kultura romake.



Një pamje nga luftërat iliro-romake

Gjatë kësaj kohe shumë ushtarakë ilirë arritën pozita të larta udhëheqëse, duke u bërë gjeneralë të shquar, por edhe perandorë. Perandorë të shquar romakë me origjinë ilire ishin Aureliani, Diokleciani dhe Konstandini i Madh.



Aureliani



Diokleciani



Konstandini i Madh

Disa qytete ilire u bënë qendra të rëndësishme të qytetërimit romak. Qytetet më të dalluara të kësaj kohe ishin Durrësi, Lisus (Lezha), Risani, Shkodra dhe Ulpiana e Dardanisë. Shenja të këtyre qyteteve të vjetra ilire mund të shohim edhe sot në disa qytete të sotme në Shqipëri e në Kosovë.



Kalaja e Rozafatit në Shkodër



Qyteti Bylys

Përkundër pushtimeve nga grekët dhe romakët, ilirët arritën të ruanin gjuhën dhe kulturën e tyre. Për fat të keq, janë ruajtur shumë pak dëshmi për gjuhën e ilirëve. Gjatë historisë, ilirët pranuan edhe vlera të popujve të tjerë.



Ulpiana, qytet ilir në Dardaninë antike, afër Prishtinës

Aktivitete:

1. Nga librat dhe nga interneti, gjeni të dhëna për perandorët romakë me prejardhje ilire, Dioklecianin, Konstandinin e Madh dhe Aurelianin!
2. Shkruani çka keni mësuar për ilirët dhe luftërat e tyre. Bëni një poster me tekst dhe me fotografi!
3. Përgatitni një prezantim 10 minutësh në klasë për Ilirët në periudhën romake!

5. SHQIPTARËT DHE PERANDORIA BIZANTINE

Perandoria Romake u nda në dy pjesë, në atë të Perëndimit dhe të Lindjes. Trevat ilire hynë në përbërje të Perandorisë Romake të Lindjes, e cila quhej Perandoria Bizantine. Kryeqytet i kësaj perandorie ishte Bizanti, që për nder të Konstandinit të Madh u emërtua Konstandinopojë (Stambolli i sotëm në Turqi).

Perandori romak me origjinë ilire, Konstandini i Madh, kishte lejuar besimin në një zot dhe kishte pranuar fenë e krishterë. Kjo fe u përhap edhe në Iliri. Shumë familje e pranuan fenë e krishterë, por, kur u bë ndarja e Perandorisë Romake në dy pjesë (shek.IV), edhe besimi (feja) e krishterë u nda në atë të Perëndimit dhe në atë të Lindjes (shek. XI).

Edhe në Perandorinë Bizantine shumë ilirë kanë bërë karrierë të lartë. Perandorë të shquar me perjardhje ilire njihen: Anastasiusi I, Justini I dhe, më i njohuri, Justiniani I.

Perandoria Bizantine u sulmua nga popuj të tjerë, si hunët, ostrogotët, vizigotët dhe sllavët.

Rreth shekujve X-XI, disa familje të fuqishme shqiptare krijuan principatat. Një ndër principatat më të njohura ishte Principata e Arbrit, me qendër në Krujë, e udhëhequr nga Princi Dhimitër Progoni. Që nga kjo kohë u përdorën emërtimet *arbrit* për banorët dhe *Arbëria* për vendin.

Familje të tjera të shquara ishin Balshajt, me qendër në Shkodër e në Ulqin, Shpatajt, me qendër në qytetin Arta (qytet në Greqinë e sotme) e më vonë Dukagjinët, Arianitët dhe Kastriotët. Çdo familje princore kishte flamurin dhe stemën e vet. Ato jetonin në kështjella të rrethuara me mure të larta dhe kishin orendi të bukura, stoli argjendi, qëndisima, qilima e zbukurime të ndryshme. Këto familje shpesh shtronin gosti për miqtë e tyre dhe përgatitnin tryezë të begatshme.





Festohej Dita e Verës, Dita e Shën Gjergjit, Dita e Shën Gjonit, Darka e Lamës dhe Festa e Buzmit. Këto festa shoqëroheshin me këngë, valle dhe me ndezje të zjarreve.







Konstandini i Madh,
mozaik në Kishën e
Shën Sofisë, Stamboll



Justiniani I

Nr.	Principata	Flamuri
1.	Principata e Arbrit	
2.	Principata e Muzakajve	
3.	Principata e Kastriotëve	
4.	Principata e Dukagjinëve	



Aktivitete:

1. Përmendni disa nga familjet princore dhe tregoni vendbanimet e tyre në hartë!
2. Vizatoni simbolet e Topiajve, të Balshajve dhe të Kastriotëve dhe ngjyrosini ato!
3. Bisedoni në klasë për ngjashmërinë e flamujve dhe të stemave në vende të ndryshme të Evropës!
4. Kërkoni në libra dhe në internet dhe gjeni informacione shtesë për arbit në periudhën bizantine!

6. ARTI DHE KULTURA SHQIPTARE NË BIZANT

Arti dhe kultura shqiptare në periudhën e Bizantit është zhvilluar kryesisht nën ndikimin e kishës. Këtu gjetën përdorim të gjerë sidomos piktura, skulptura e arkitektura. Arti figurativ shqiptar në këtë kohë u dallua me pikturimin e mureve brenda kishave dhe manastireve. Ato u mbushën me afreske dhe ikona. Ikonat janë piktura të shenjtërve të krishterë. Në gjysmën e dytë të shekullit XVI jetonte artisti me nam botëror Nikolla Onufri, piktor i njohur shqiptar i ikonave.



Afreskat në Kishën e Shën Todhrit, Berat



Disa nga ikonat e Onufrit



“Kodiku i Purpurtë i Beratit” shek VI, (dorshkrim i vjetër)

Kultura shqiptare e Bizantit përfshin edhe objekte të ndryshme si kala, ura, mullinj, kisha, manastire, ikona, murale, mozaikë etj. Me gdhendje të skulpturave janë zbukuruar dyert, shtyllat dhe dritaret e objekteve fetare. Disa nga këto elemente i hasim në Kishën e Mosopotamit, pranë Sarandës, në Manastirin e Deçanit etj.




Kalaja e Beratit

Në këtë periudhë muzika ishte po ashtu pjesë e rëndësishme e jetës. Këndohej (ninulla, lutje fetare, vajtime, këngë për legjenda etj). Përdorshin



Niketë Dardani

edhe vegla muzikore për shoqërimin e këngëve dhe të valleve në martesë dhe në raste të ndryshme. Në këtë kohë ishte e zhvilluar kryesisht muzika artistike kishtare dhe shquhen dy priftërinj muzikantë: Niketë Dardani, prift katolik i shekullit të IV-të nga Dardania, dhe Jan Kukuzeli, prift nga Durrësi (shek XII).



Jan Kukuzeli

Në këtë kohë më të moshuarit tregonin përralla e histori të ndryshme për të kaluarën. Shpesh, ata që dinin të këndonin (rapsodët), u tregonin më të rinjve histori dhe legjenda, duke luajtur me lahutë. Këndohej për trimat si Gjergj Elez Alia, që luftonin kundër pushtuesve “kralë” e “kapedanë” nga vendet përtej detit, por edhe kundër bajlozëve, dragojve e kuçedrave. Por kishte edhe histori për Të bukurën e dheut dhe zanat e malit, që ishin gra të bukura e luftëtare. Besohej, se ato banonin në shpella mes pyjesh ose pranë burimeve.



Kuçedra përfytyrohej si një qenie mitologjike, që mishëronte forcat e verbra shkatërruese të natyrës. Thuhej se ajo ishte si një gjarpër i madh me 3, 7, 9 ose 12 koka, që mund të villte zjarr. Zinte vend pranë burimeve, ndalonte ujin dhe i bënte njerëzit të vuanin.

Dragoi përfytyrohej si një qenie e mbinatyrshme me fuqi mbinatyrore. Bëma e tij kryesore ishte të lironte ujërat, që i kishte zënë kuçedra. Besohej se dragojtë luftonin sidomos në kohë furtunash të mëdha, duke përdorur topuzat, heshtat, shigjetat, gurët. Ata mund të shkullnin edhe drunj të mëdhenj e gurë të malit.

Pikturë e Guri Madhit me motive shqiptare

Legjenda e Konstandinit dhe Doruntinës për besën (fjalën e dhënë) është shumë e njohur. Besohej se atë që e thyen besën mallkimi mund ta ndjekë edhe pas vdekjes.

Aktivitete:

1. Krijoni një punim artistik, poster, pullë postale me ndonjë hero nga legjendat!
2. Bëni dramatizimin e rrëfimit për Konstantinin dhe Doruntinën!
3. Mëso edhe ndonjë legjendë tjetër shqiptare!
4. Gjej dhe lexo ndonjë legjendë të ngjashme në vendin ku jeton!

7. SHQIPTARËT DHE PERANDORIA OSMANE

Perandoria Osmane ishte perandori e fuqishme e kohës. Kjo perandori sulmoi Arbërinë dhe vendet e tjera fqinje. Disa princër të këtyre vendeve u bashkuan për të çliruar vendin nga pushtimi osman. Në vitin 1389 u zhvillua një betejë e përgjakshme në Fushën e Kosovës, afër Prishtinës së sotme, e cila njihet si “Beteja e Kosovës”. Në këtë betejë, ushtritë e këtyre vendeve pësuan humbje. Aty u vranë disa nga këta princër (Teodor Muzaka II, Princ Llazari) si dhe Sulltan Murati. Ushtritë ballkanase u thyen dhe osmanët pushtuan përfundimisht këto vende, të cilat i sunduan afër 5 shekuj.



Lekë Pervizi: “Betejat shqiptare”



Stema e familjes
Kastrioti

Në Arbëri, gjatë kësaj periudhe, princat shqiptarë u detyruan t'u shërbenin sulltanëve osmanë. Ata i detyronin princat të paguanin taksa dhe të dorëzonin pasuritë e tyre. Osmanët ua merrnin edhe djemtë e tyre peng dhe i dërgonin në shkolla ushtarake. Ata e morën peng edhe Gjergj Kastriotin. Ai ishte djali më i vogël i princit Gjon Kastrioti, nga Principata e Kastriotëve, e cila sundonte tokat shqiptare nga Dibra deri në Krujë.

8. LUFTËRAT E SKËNDERBEUT PËR LIRI

Gjergj Kastrioti (1405 - 1468) mbaroi shkollën ushtarake osmane dhe u bë luftëtar i shquar. Atij iu dha titulli Beg (udhëheqës) dhe u quajt Skënderbeu. Mirëpo Gjergji nuk e harroi kurrë atdheun e vet të robëruar. Më 28 nëntor 1443, Skënderbeu u kthye në Krujë, ku ngriti flamurin e lirisë dhe udhëhoqi luftën për çlirim. Disa muaj më vonë (1444), Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i mbledhi princërit shqiptarë në Kuvendin e Lezhës. Aty u lidh besa për luftë kundër pushtuesit osman. Skënderbeu aty u zgjodh udhëheqës i Besëlidhjes Shqiptare.



Kështjella e Krujës

Për 25 vite me radhë, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu me trimat e tij luftoi kundër osmanëve. Kruja u rrethua disa herë nga ushtria osmane dhe nga vetë sulltanët, por ata përherë u kthyen të mundur dhe të turpëruar. Pas shumë luftërave të mëdha, Skënderbeu u sëmur dhe vdiq në vitin 1468. Amaneti i tij për trimat ishte të qëndronin të bashkuar. Gjergj Kastrioti-



*Portreti i Skënderbeut në Itali
(Galeria "Uffizi" në Firencë)*

Skënderbeu është hero i të gjithë shqiptarëve kudo që ata jetojnë. Fitoret e tij kundër Perandorisë Osmane përshendeteshin me nderim nga vendet e Evropës, meqë ai e pengoi depërtimin e Perandorisë Osmane në Evropë. Për këtë Skënderbeut i kanë ngritur përmen-dore në shumë qytete shqiptare, si në Krujë, në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup por edhe në qytete të tjera të Evropës.

Për Skënderbeun populli krijoi këngë, vargje, tregime e legjenda të bukura. Për të shkruan edhe shumë shkrimtarë e historianë shqiptarë dhe të huaj.



Përkrenarja origjinale e Skënderbeut në një muze të Vjenës në Austri



Vula e Skënderbeut në Muzeun e Kopenhagës, Danimarkë



Viset e Italisë ku jetojnë Arbëreshët

Pas vdekjes së Skënderbeut, shqiptarët mbetën nën sundimin e Perandorisë Osmane për afro 5 shekuj. Shumë shqiptarë, përfshirë edhe vetë familjen e Skënderbeut, u larguan në Itali dhe në vende të tjera të Evropës. Ata që u vendosën në Kalabri, në Sicili dhe në vendbanime të tjera të Italisë njihen si arbëreshë. Sot në këto fshatra ende ruhet gjuha dhe botohen libra, gazeta. Nga arbëreshët e Italisë kemi poetë të shquar, si Jeronim de Rada, Gavril Dara, Jul Variboba, Zef Serembe etj. Kënga e bukur arbëreshe “**E bukura More**” i kushtohet mallit për atdhe.

POROSIA E FUNDIT E SKËNDERBEUT

Skënderbeu, para se të vdiste, thirri pranë vetes trimat e tij. Iu drejtua më të riut e i tha:

- Gjin, ti je ri e i fuqishëm. Merri ato thupra dhe ashtu, grumbull siç janë, thyeji! Djaloshi mori thuprat dhe u përpoq me gjithë fuqinë, por s'i theu dot. Pas tij provuan edhe dy-tre të tjerë, por as ata nuk mundën t'i thyenin. Atëherë Skënderbeu iu drejtua të birit:

- Gjon, veçoji thuprat e thyeji një nga një!

Gjoni i theu të gjitha.

- Siç e patë, - tha Skënderbeu, - as më i fuqishmi nga ju s'mundi t'i thyejë thuprat së bashku. Kurse një nga një i theu edhe Gjoni, që është ende i vogël. Prandaj, porosia ime e fundit është: Qëndroni gjithmonë të bashkuar, sepse kështu edhe pa mua do të fitoni. Arbërisë nuk i kanë munguar kurrë trimat. Betohuni!

Menjëherë, të gjithë trimat nxorën shpatat dhe thirrën:

- Betohe mi!

Luftërat për liri vazhduan edhe pas vdekjes së Skënderbeut.

MOJ E BUKURA MORE



*Moj e bukura Moré,
si të lashë
më s'të pashë!*

*Atje kam unë zotin tatë,
atje kam unë zonjën mëmë,
atje kam unë tim vëlla!*

*Moj e bukura Moré,
si të lashë
e më s'të të pashë!*



Dëgjo këtë këngë të bukur të kënduar nga këngëtarja e shquar shqiptare Inva Mula (<http://www.youtube.com/watch?v=pskWw3yfpcQ>) ! Mësoni melodinë e saj!

Aktivitetet:

1. Mësoni më shumë për Skënderbeun dhe heroizmin e tij!
2. Prezantoni në klasë njohuritë e reja për Skënderbeun që keni marrë nga librat, nga interneti apo nga bisedat me më të rriturit!
3. Bisedoni në klasë a ka heronj të ngjajshëm në vendin ku jetoni ju tani.
4. Vizatoni një portret ose punoni një pikturë nga ngjarjet që lidhen me Skënderbeun!
5. Gjeni filmin artistik "Skënderbeu" në DVD! Shikojeni dhe bisedoni për te në klasë!
6. Imagjinoni një bisedë me Skënderbeun! Çfarë do ta pyesnit atë?
7. Mësoni ta këndoni këngën "E bukura More" me ndihmen e mesuesit / es!

Përmes këngëve mësojmë për të kaluarën

MOJ ARBËRI

Në det pul'bardhat çajn' fluturim
si kënga jon' plot mall
këndojn' nga larg me dashuri,
moj Arbëri.

Arbëreshët e Italië edhe sot
e kësaj dite kujtojnë me mall
atdheun e të parëve duke i
kushtuar edhe këngë shumë
të bukura.

Me ndihmën e mësuesit,
prindërve ose ndonjë muzik-
tari profesionist mësoni ta
këndoni këtë këngë të bukur
arbëreshe.

Dëgjojeni këtë këngë të kën-
duar nga këngëtarja e shquar
shqiptare Aurela Gaçe, duke
klikuar në:

[http://www.youtube.com/
watch?v=SPyqIHsIkuA](http://www.youtube.com/watch?v=SPyqIHsIkuA)

Të parët tan' me breng' të lart'
sa koh' më nuk të pam'
por sot si lule ti më je,
moj Shqipëri.

Ref. Valët e detit shkumbojn' plot dallg',
bashkë me shokë në breg kemi dal'
sa kemi mall s'ka deti val',
o moj e bukur Arbëri,
shikojm' nga larg me dashuri,
o moj e bukur Shqipëri.

CODA:

2X Shikojm' nga larg, mendojm' për ty,
o moj e bukur Shqipëri.

Aktivitete:

1. Në internet provoni të gjeni këngë dhe valle të tjera të bukura arbëreshe.
2. Gjeni fotografi dhe pastaj vizatoni dhe ngjyrosni kostume të ndryshme arbëreshe!

MOJ ARBËRI

♩ = 150

INTROD. *Fm* *Cm* *Fm* *E^b* *Fm* *Cm*

VOC. *Cm* *(FR)* *Fm* *G⁷*

LIË DET PUL - MAR - INAT SAJN, FLUTU - RIN SI KËU - GA SËU PLOT MALL

Fm⁹ *D⁹* *F⁹* *G⁷* *Cm*

KËU - DOJN' NGA LARG ME DA - SHU - RI MOJ AR - BË - RI

Fm *E^b* *Fm* *(G⁷)*

TË KA - RËT TAN' ME BREGË TË LART' SA KON' MË NUK TË

G⁷ *Fm⁹* *D⁹* *E^b* *G⁷*

PAR SOT SI LU - LE TI MË JË, MË SHRI - PË -

PAN *Cm* *D⁹* *Fm⁷* *F⁹* *Fm⁹* *Fm⁹*

RI - VA - LET E JË - TIT SHKURROJN' DOR DALLË

Fm *D⁹* *E^b* *G⁷* *Fm*

BASHK' ME SHOKË MË BREGTINI DAL' SA KE - MI MALL

D⁹ *E^b* *Cm* *(1. D⁹)* *(A^b)* *G⁷* *(2. Fm⁹)*

SËA DE TI VAL' O MOJ E RI - KUR AR - BË - RI BU - KUR

G⁷ *Cm*

Da Capo al FINE e poi Coda

G⁷ *Cm*

SHRI - PË - RI

Coda *Fm* *D⁹* *E^b* *A^b* *Fm*

SHI - KON' NGA LARG, MENDOJM' PËR TY O MOJ E

(b^b) *Fm* *D⁹* *E^b* *A^b* *Fm*

BU - KUR SHRI - PË - RI SHI - KON' NGA LARG, MENDOJM' PËR TY

A^b *Fm⁹* *G⁷* *Cm*

O MOJ E RI - KUR SHRI - PË - RI

9. PËRPJEKJET PËR RUAJTJEN E GJUHËS DHE TË KULTURËS

Shqiptarët dhe popujt e tjerë të Ballkanit, që mbetën nën sundimin osman, nuk arritën të zhvilloheshin përkrah popujve të tjerë evropianë. Nga një pjesë e shqiptarëve feja islame u pranua. Prandaj në trojet e Arbërisë u ndërtuan edhe objekte fetare të kësaj feje, si xhamitë, teqet etj.

Shqiptarët dalloheshin si mjeshtër të shquar për ndërtimin e kështjellave, të urave, të ujës-jellësve etj. Shumë nga këto ndërtime janë ruajtur edhe sot e kësaj dite. Emra të njohur nga kjo fushë

janë arkitektët shqiptarë Mimar Sinani dhe Mehmet Isai. Ky i fundit e projektoi edhe Taxh Mahallën, e cila njihet si një ndër shtatë mrekullitë e botës.

Mirëpo edhe gjatë sundimit osman shqiptarët vazhduan përpjekjet për ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës së tyre. Në këto përpjekje u shquan Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Lekë Matrënga, Frang Bardhi, Papa Klementi, Pjetër Bogdani, Nezim Frakulla etj.



Xhamia e Muradijes në Vlorë e ndërtuar nga arkitekt Sinani me prejardhje shqiptare



Kalaja e Gjirokastrës



Kalaja e Prizrenit

GJATË SUNDIMIT OSMAN



Gjon Buzuku

Gjon Buzuku është autor i librit të parë në gjuhën shqipe të njohur deri tash. Ky libër quhet “Meshari” dhe u botua në vitin 1555.



Pjetër Budi
(1566-1622)

Pjetër Budi shërbeu si prift katolik në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni dhe u angazhua për çlirim nga pushtimi osman. Veprat e tij më të njohura janë “Doktrina e kërshtenë” dhe “Pasqyra e të rrëfyemit”.



Pjetër Bogdani
(1630-1689)

Pjetër Bogdani, nga Hasi i Prizrenit, ishte nip i kryepeshkopit katolik të Shkupit, Andrea Bogdani. Ai ishte doktor i filozofisë dhe teologjisë. Shërbeu si prift në Shkodër dhe në Shkup. Pjesën e fundit të jetës e kaloi duke rezistuar sundimin osman në Kosovë. Ai vdiq dhe u varros në Prishtinë. Njihet si figurë e shquar e kulturës shqiptare. Vepra tij më e njohur është “Çeta e profetëve”.



Papa Klementi XI
(1649-1721)

Gjon Françesk Albani (Papa Klementi XI) rrjedh nga familja Albani dhe shërbeu si Papë në vitet 1700-1721. Ai ndihmoi që të botohet “Illyricum Sacrum” një burim shumë i rëndësishëm historik me mbi 5000 faqe, kushtuar Ilirisë. Gjithashtu, kontribuoi në organizimin e Kuvendit të Arbërit, i cili u mbajt në janar të vitit 1703 në Dioqezën e Lezhës. Kuvendi kishte karakter kombëtar dhe fetar. Papa Klementi i XI, me të ardhur në krye të kishës katolike, urdhëroi organizimin e këtij kuvendi. Në kuvend u diskutua jo vetëm mbajtja e shkollave shqipe pranë famullive që ekzistonin, por edhe rihapja e tyre, pasi që ishin mbyllur nga osmanët.

Aktivitete:

1. Gjeni në internet dhe në burime të tjera më shumë informata për këto figura të shquara kombëtare!
2. Bëje një album me fotografi të këtyre figurave të njohura!

10. LIDHJA E PRIZRENIT

Në vitin 1877, ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Rusisë, u zhvillua një luftë e madhe, me ç'rast u thye ushtria osmane. Sulltani u detyrua të nënshkruante një marrëveshje, sipas së cilës gjysma e trojeve shqiptare do t'u jepej shteteve fqinje, Serbisë e Malit të Zi.

Përballë rrezikut të copëtimit të vendit, atdhetarët shqiptarë u mbledhën në Prizren në një kuvend të përgjithshëm, më 10 qershor 1878. Aty u formua Lidhja e Prizrenit.

Lidhja formoi forcat vullnetare të armatosura për mbrojtjen e vendit dhe zgjodhi udhëheqës të saj Ymer Prizrenin, Abdyl Frashërin e Sylejman Vokshin.



*Harta e vilajeteve osmane
ku përfshiheshin edhe territoret shqiptare*



Abdyl Frashëri



Ymer Prizreni



Sylejman Vokshi

NGJARJE E RËNDËSISHME KOMBËTARE

Për më shumë se një vit, forcat e Lidhjes së Prizrenit arritën të mbrojnë me sukses trojet shqiptare.

Përkundër përpjekjeve për mbrojtjen e trojeve shqiptare, fuqitë e mëdha në Kongresin e Berlinit (1878) vendosën që disa vise shqiptare t'u jepen vendeve fqinje.



Pamje nga dita e themelimit të Lidhjes së Prizrenit



Sali Shijaku: Mic Sokoli



Veshje shqiptare në Muzeun e Lidhjes së Prizrenit

Aktivitete:

1. Çka ndodhi me trojet shqiptare pas luftës ruso-osmane dhe pas marrëveshjes së tyre?
2. Kur dhe pse u organizua Lidhja e Prizrenit?
3. Cilët ishin udhëheqësit kryesorë të Lidhjes së Prizrenit?
4. Kërkoni më shumë të dhëna nga librat dhe nga interneti për Lidhjen e Prizrenit!
5. Vizitoni shtëpinë muze të Lidhjes së Prizrenit!

11. RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE-

Shumë patriotë vepruan brenda dhe jashtë trojeve shqiptare për çlirimin nga pushtimi osman. Ata punuan shumë edhe për ruajtjen dhe përhapjen e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Kjo periudhë në historinë e kombit tonë njihet si Rilindja Kombëtare.

Në këtë kohë u shkruan abetaret dhe librat e parë për mësimin e gjuhës shqipe. Po ashtu, u hap edhe shkolla e parë shqipe “Mësojtorja”, më 7 mars 1887 në Korçë. Kjo datë festohet si “Dita e Mësuesit-es”. Shkolla të tjera shqipe u hapën në Prizren (1889), në Zllakuqan të Klinës (1897) etj.



Mësojtorja e parë shqipe



*Shtjefën Gjeçovi
(1873-1929)*

At Shtjefën Gjeçovi u lind në Janjevë. Ai e hapi shkollën shqipe në Zllakuqan më 1897. Si etnograf i shquar njihet për punën e tij shumëvjeçare në përgatitjen për botim të “Kanunit të Lekë Dukagjinit”.

Rilindësit me veprat e tyre letrare ndikuan shumë në formimin e vetëdijes kombëtare të popullit.



Muzeu Historik i Arsimit Shqip në Korçë është ndërtesa ku ishte hapur shkolla e parë shqipe. Aty sot ruhen shumë dokumente e foto te ngjarjeve me rëndësi për fillet e arsimit shqiptar.



*Naum Veqilharxhi
(1767-1846)*

Naum Veqilharxhi, pas një pune të gjatë, e botoi abetaren e parë shqipe në vitin 1844, të quajtur “Ëvetar”.



*Konstandin Kristoforidhi
(1827-1895)*

Konstandin Kristoforidhi botoi dy abetare. Më 1867 abetaren në gegërishte dhe më 1868 atë në toskërishte.



*Pandeli Sotiri
(1843-1891)*

Pandeli Sotiri ishte themeluesi i shkollës së parë shqipe në Korçë. Ai gjithashtu hartoi një abetare për mësimin e gjuhës shqipe.



*Sevasti Qiriazhi
(1871-1949)*


Sevasti Qiriazhi ishte grua e shkolluar, e cila hapi shkollën e parë shqipe për vasha në vitin 1891 në Korçë.

FIGURA TË SHQUARA



Jeronim De Rada
(1814-1903)

Jeronim De Rada lindi në Kalabari të Italisë. Mblodhi letërsinë popullore arbëreshe dhe shkroi poemën e tij të njohur liriko-epike “Këngët e Miosaos”, më 1836.



Naim Frashëri
(1846-1900)

Naim Frashëri lindi në Frashër. Vepra të tij të njohura janë: “Bagëti e bujqësia”, “Historia e Skënderbeut” etj.



Sami Frashëri
(1850-1904)

Sami Frashëri lindi në Frashër. Vepra kryesore e tij është “Shqipëria ç’ ka qenë, ç’ është dhe ç’ do të bëhet”. Kjo vepër u bë programi i lëvizjes kombëtare për pavarësimin e Shqipërisë.



Ndre Mjeda
(1866-1937)

Ndre Mjeda lindi në Shkodër. Vepra e tij më e njohur është “Juvenilja”.

Një pengesë e zhvillimit të arsimit dhe të kulturës ishte mungesa e alfabetit shqip. Librat e shkruar në gjuhën shqipe gjatë kësaj kohe kombinonin alfabetin latin, grek e arab. Patriotët si Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi etj. u mblodhën në qytetin e Manastirit. Aty, më 1908, u mbajt “Kongresi i Manastirit”, ku u vendos alfabeti shqip me 36 shkronja, që përdoret edhe sot.



Gjergj Fishta
(1871-1940)

Gjergj Fishta lindi në Fishtë të Lezhës. Ishte një ndër figurat më meritore për mbajtjen e Kongresit të Manastirit. Ai shkroi poemën e njohur “Lahuta e Malësisë”, që konsiderohet si Iliada shqiptare. Ishte kandidati i parë shqiptar për çmimin Nobel për letërsi.



Mithat Frashëri
(1880-1949)

Mithat Frashëri lindi në Janinë. Ishte kryesues i Kongresit të Manastirit. Ai ishte edhe diplomat, shkrimtar dhe politikan i shquar.

Aktivitete:

1. Shikoni në DVD filmat artistikë: “Mësonjtorja” dhe “Udha e shkronjave” dhe mësoni më shumë për historikun e shkollës shqipe.
2. Krahasoni alfabetin e gjuhës shqipe me atë të gjuhës së vendit ku jetoni, numrin dhe ngjajshmërinë e shkronjave!
3. Organizoni një program artistik me poezi, këngë e valle me rastin e 7 Marsit!
4. Nga interneti dhe librat, mësoni më shumë për figurat e shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare!

12. ARTET NË RILINDJEN KOMBËTARE

Rilindja Kombëtare Shqiptare është periudhë e ndritshme e artit dhe e kulturës kombëtare. Në këtë kohë u themelua shkolla e vizatimit, e cila pati ndikim të madh në zhvillimin e artit figurativ. Gjithashtu u hapën ekspozitat e para të artit figurativ në Shqipëri dhe u shpallën konkurse të ndryshme për shtatore. Artistë të shquar të kësaj periudhe janë Kolë Idromeno, Murat Toptani etj.



Kolë Idromeno, autoportret (1860-1939)

Kolë Idromeno ishte piktor, scenograf, arkitekt, muzikant e kinematograf. Pikturë e tij e njohur është “Motra Tone”. Këtë vepër ai e realizoi për të plotësuar dëshirën e motrës së tij me veshjen e bukur shkodrane.



Kolë Idromeno: "Motra Tone", pikturë me ngjyra vaji, Shkodër, 1883



Murat Toptani me veshje kombëtare. Fotografuar nga Marubi (1868-1917)

Murat Toptani është i njohur me skulpturën e bustit të Skënderbeut. Në studion Marubi në Shkodër ai bëri një fotografi me veshje kombëtare. Figura e tij me fustanellë paraqet karakterin burrëror e krenar të shqiptarit. Veprat e tij u shpërndanë në disa vende, si në Itali, në Turqi, në Rumani e në Bullgari.



Murat Toptani: "Skënderbeu"



Pjetër Marubi ishte arkitekt, piktor dhe fotograf që ushtroi fotografinë në Shkodër. Ai qysh në vitin 1856 fotografoi personalitete dhe ngjarje politike të kohës, si p.sh. “Kryengritja e Mirditës” (1876-77), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” (1878-81) etj. Këto foto u publikuan edhe në faqet e revistave të njohura evropiane. Pas vdekjes, studion e tij e drejtoi Kel Marubi. Keli edhe djalin e shkolloi në Paris dhe kështu kemi tre breza fotografësh, Pjetri-Keli-Gega. Veprat e tyre sot ruhen në Fototekën e Shkodrës.

Vëllezërit **Manaki** nga Manastiri vunë hapat e parë të filmit shqiptar. Ata xhiruan në Shqipëri dhe në vende të ndryshme të Ballkanit ngjarje të ndryshme. Në vitin 1906, ata prodhuan filmin e shkurtër dokumentar “Lojna e kostume popullore” të bazuar në xhirimet e bëra në qytetet e Korçës, Përmetit, Këlcyrës dhe Janinës.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, krahas muzikës popullore që ishte mjaft e zhvilluar, u hodhën edhe hapat e parë të muzikës artistike shqiptare. U krijuan bendet (orkestrinat) e para muzikore me instrumentet me frymë, si ajo në Shkodër. Temat që trajtoheshin në muzikën shqiptare ishin nga jeta e përditshme, ku dominonte tema e dashurisë për atdheun.



Palokë Kurti (1860-1920)

Vepra më e shquar muzikore e kësaj kohe është marshi muzikor “Bashkimi i Shqipërisë”, e kompozuar nga kompozitori Palokë Kurti, më 1881.



Banda e parë muzikore në Shkodër



Kolë Idromeno: Dasma shkodrane

Aktivitete:

1. Krahaso veprat e njohura shqiptare të artit figurativ nga kjo periudhë me veprat e kohës së re!
2. Dëgjo dhe mëso edhe ndonjë këngë popullore qytetare nga vise të ndryshme shqiptare!


13. KRIJIMI I SHTETIT SHQIPTAR

Shpallja e pavarësisë

Kryengritjet e viteve 1910-1912 në Kosovë dhe në Shqipëri kishin për synim krijimin e shtetit shqiptar. Më 28 nëntor 1912, në Vlorë, u shpall pavarësia e shtetit shqiptar. Kuvendin e drejtoi Ismail Qemali, i cili u zgjodh kryeministër i qeverisë së parë shqiptare. Kjo datë festohet nga të gjithë shqiptarët kudo në botë dhe njihet si Dita e Flamurit Kombëtar.



Pamje nga shpallja e pavarësisë në Vlorë (1912)



Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë

Flamuri në Vlorë u ngrit duke u kënduar himni, që është tekst i poezisë së Asdrenit “Betimi mbi flamur”. Që nga ajo ditë ky është pranuar si himn shtetëror i Shqipërisë. Por, ky himn është po ashtu kombëtar dhe këndohet nga të gjithë shqiptarët.



Pritja e Princ Vidit në portin e Durrësit



Zef Shoshi: Isa Boletini me trima

Shtetet evropiane perëndimore e njohën pavarësinë e Shqipërisë, por jo në tërë territorin e saj. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e cila u mbajt më 1912-1913, vendosi që Kosova dhe Maqedonia Perëndimore të mbeten nën sundimin e Serbisë dhe të Malit të Zi, kurse Çamëria dhe disa vise të Shqipërisë Jugore mbetën nën sundimin e Greqisë. Austro-Hungaria e ndihmoi shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjen e saj në Konferencën e Londrës. Fuqitë e Mëdha në këtë konferencë vendosën ta dërgonin në Shqipëri princin Vilhem Vid si udhëheqës të shtetit të ri shqiptar.

Mospërfshirja e shumë viseve shqiptare në shtetin e sapoformuar shqiptar ishte padrejtësia më e madhe historike që iu bë popullit tonë. Me këtë ndarje shqiptarët kurrë nuk u pajtuan. Trimat, si Isa Boletini me shokë, vazhduan luftërat për liri.

Aktivitete:

1. Lexoni më shumë për Pavarësinë e Shqipërisë!
2. Shikoni në DVD filmin “Nëntori i Dytë” dhe bisedoni për ngjarjen!
3. Mësoni tekstin dhe melodinë e himnit kombëtar!
4. Mësoni më shumë nga librat dhe interneti për Ismail Qemalin dhe Isa Boletinin!

14. PERIUDHAT PAS PAVARËSISË

Me krijimin e shtetit shqiptar u krijua mundësia për zhvillim të gjithanshëm. Mirëpo, problemet dhe pengesat nuk morën fund.

Periudha gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore

Lufta e Parë Botërore (1914-1918) e gjeti shtetin shqiptar të brishtë. Fuqitë e Mëdha tashmë luftonin në mes vete. Shqipëria dhe trojet shqiptare jashtë saj u pushtuan nga disa prej këtyre shteteve. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Paris u mbajt Konferenca e Paqes në të cilën u konfirmuan kufijtë ekzistues të Shqipërisë.

Në këto rrethana u mbajt Kongresi i Lushnjës, i cili kishte për qëllim mbrojtjen e trojeve shqiptare. Aty u formua qeveria e re, e cila më vonë kaloi në Tiranë.

Që nga ajo datë (11.02.1920), Tirana u bë kryeqyteti i Shqipërisë.

Në Kosovë regjimi serb ushtroi dhunë ndaj popullsisë shqiptare. Patriotë të shquar si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hoxhë Kadri Prishtina, Idriz Seferi, Azem e Shote Galica etj. formuan komitetin “Mbrotjja Kombëtare e Kosovës” dhe organizuan luftëra të armatosura për çlirim.



*Bajram Curri
(1862-1925)*

Bajram Curri u lind në Gjakovë. I rritur me idetë e Lidhjes së Prizrenit, kontribuoi për themelimin e shkollave shqipe në Kosovë dhe luftoi parreshtur për bashkimin e trojeve shqiptare.



*Hasan Prishtina
(1873-1933)*

Hasan Prishtina u lind në Vushtrri. Studioi për drejtësi dhe politikë në Stamboll. Ishte një nga ideologët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ai e dha gjithë pasurinë e tij për arsimimin e shqiptarëve në Kosovë dhe për çlirimin e saj.

Mbretëria Shqiptare (1928-1939)

Në vitin 1925 u shpall Republika Shqiptare, ku organi më i lartë ligjvënës ishte parlamenti. **Ahmet Zogu** u zgjodh president i

Republikës. Më 1928, Zogu vendosi të krijojë mbretërinë shqiptare. Mbreti Zog mori masat për organizim e ri të shtetit, me ç'rast u hartuan edhe ligjet sipas modelit të shteteve evropiane. Në këtë periudhë filloi një përparim në disa sfera. U ndërtuan shumë rrugë, porte dhe u zhvillua shërbimi postar. Gjithashtu, u krijua edhe sistemi arsimor kombëtar dhe u zhvilluan arti e kultura.



*Mbreti Ahmet Zogu
(1895-1961)*

Figura të shquara në fushën e letërsisë të kësaj periudhe janë Fan Noli, Faik Konica, Migjeni, Ernest Koliqi etj. Në artet figurative u shquan Vangjush Mio, Odhise Paskali, Abdurrahim Buza etj., kurse në fushën e muzikës u dalluan Martin Gjoka, Toma Nasi dhe këngëtares Tefta Tashko e Marie Kraja.



*Fan Stilian Noli
(1882-1965)*

Theofan Stilian Noli njihet si shkrimtar, hulumtues, diplomat, politikan, historian, orator dhe themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare. I shkolluar në Universitetin e Harvardit, ai përktheu shumë kryevepra botërore në gjuhën shqipe. Ai shkroi për Skënderbeun, Shekspirin, Beethovenin etj.

Periudha gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore

Lufta e Dytë Botërore (1939-1944) solli pushtimin fashist të trojeve shqiptare nga Italia, Gjermania dhe nga aleatët e tyre. Shqiptarët organizuan luftën e armatosur për çlirim dhe bashkim të të gjitha trojeve shqiptare.

Por, mjerisht, edhe pas Luftës së Dytë Botërore Kosova dhe disa vise shqiptare mbetën përsëri të ndara. Ato mbetën pjesë e shtetit të quajtur Jugosllavi.

Sikurse edhe në pjesën më të madhe të Evropës, në Shqipëri, në Kosovë dhe në vise të tjera, ku jetonin shqiptarët, u vendos regjimi komunist. Ky regjim ishte jo demokratik dhe i ashpër posaçërisht për popullin shqiptar, edhe pse kishte përparime në disa fusha, si në arsim, në kulturë etj.



Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë

Aktivitete:

1. Lexo më shumë për Bajram Currin e Hasan Prishtinën!
2. Gjej më shumë informata për Mbretin Zog dhe Mbretërinë Shqiptare!
3. Nëse dëshironi të dëgjoni një fjalim të Fan Nolit, hyni në internet në <http://www.albanianlanguage.net/en/noli.html>
4. Mëso më shumë nga librat dhe nga interneti për figurat e shquara shqiptare nga periudha midis dy luftërave botërore!

15. SHQIPTARËT SOT



HARTA E VISEVE TË BANUARA ME SHQIPTARË

- Shqiptarët në Shqipëri
- Viset e banuara me shumicë shqiptare
- Viset ku shqiptarët janë pakicë

Shqiptarët sot jetojnë kryesisht në dy shtete të pavarura në Ballkan; në Shqipëri dhe në Kosovë. Në këto dy shtete ata janë popull shumicë. Shqiptarët jetojnë edhe në trojet e tyre në shtetet fqinje; në Maqedoni, në Serbi dhe në Mal të Zi. Ata jetojnë si komunitet i organizuar edhe në Itali (arbëreshët) dhe në Greqi (arvanitasit dhe çamët).


Shqiptarët në territoret jashtë Shqipërisë, të ndarë nga trungu kombëtar, u përballën vazhdimisht me pengesa në shfaqjen e lirshme të identitetit të tyre kombëtar.

Shqiptarët në Kosovë u përballën me regjimin e egër serb, i cili synonte zhdukjen e tërësishme të tyre.

Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Në shtetin e Kosovës jetojnë edhe komunitete të tjera si serbët, turqit, malazezët, romët, boshnjakët, kroatët, goranët etj.

Shqiptarët në Mal të Zi

Në Mal të Zi shqiptarët jetojnë në Ulqin, në Tivar, në Tuz, në Malësi të Madhe, në Plavë dhe në Guci. Ulqini njihet si vend turistik. Shqiptarët e këtyre trevave, për shkaqe ekonomike dhe politike, emigruan në vende të ndryshme të botës, kryesisht në Amerikë. Për këtë arsye, numri i shqiptarëve në këto treva ditadites ka rënie.



Pamje e Ulqinit

Shqiptarët në Luginën e Preshevës

Në Serbi shqiptarët jetojnë kryesisht në Luginën e Preshevës. Qytetet kryesore në të cilat jetojnë shqiptarët janë Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Edhe në këto treva shqiptarëve nuk u respektohen të drejtat e tyre sipas standardeve ndërkombëtare. Për shkaqe ekonomike e politike, edhe nga këto treva shqiptarët emigrojnë në Kosovë dhe në vende të tjera.



Pamje e Preshevës

Diaspora (mërgata) shqiptare

Përveç në shtetet fqinje, për shkaqe kryesisht ekonomike dhe politike, shumë shqiptarë kanë lënë vendet e tyre dhe sot jetojnë në vende të ndryshme të botës. Ata janë të organizuar si komunitet në klube dhe në shoqata të ndryshme. Shqiptarët në botë e përbëjnë diasporën (mërgatën) shqiptare.



Pamje nga një organizim në Diasporë

Aktivitete:

1. Shikoni me kujdes hartën e viseve të banuara me shqiptarë dhe diskutoni për shtrirjen e tyre!
2. Tregoni me cilat vende kufizohen Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia!
3. Cili shtet ka më shumë banorë shqiptarë?
4. Sa është numri i shqiptarëve në vendin ku jeton tani?
5. Shënoni në kolonat e bardha të hartës emrat e shteteve!

16. SHQIPËRIA



Shqipëria (Albania) shtrihet në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet në veriperëndim me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në perëndim me Republikën e Maqedonisë dhe në jug me Greqinë. Ka dalje në dy detra, në Detin Adriatik dhe në Detin Jon. Vetëm 78 km e ndajnë nga Italia, përgjatë Ngushticës së Otrantos.

Shqipëria ka bukuri të shumta natyrore, vargmale të larta, lumenj, liqene, bregdet shumë të bukur (368 km gjatësi) dhe botë bimore e shtazore të pasur.



Pelikani



Shqiponja

Shqipëria tërheq turistët nga e gjithë bota. Sot ajo është një ndër vendet më tërheqëse në botë.



Shqipëria sot

Shqipëria ka arritur përparim të dukshëm ekonomik, shoqëror e kulturor.

Pas rënies së komunizmit (1991), Shqipëria ka përjetuar një periudhë të vështirë

të zhvillimit demokratik. Ajo sot është vend demokratik dhe Republikë Parlamentare. Që nga viti 2009 është antare e NATO-s dhe kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.



Fakte dhe shifra:

Sipërfaqja: 28,748 km².

Popullsia: mbi 3.5 .milion banorë.

Gjuha: Shqipe

Valuta: Leku.

Kryeqyteti: Tirana, rreth 1 milion banorë.

Qytetet kryesore: Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça, Vlora, Gjirokastra, Saranda etj.

Lumenjtë: Drini i Bardhë, Drini i Zi, Shkumbini, Vjosa, Buna, Mati etj.

Liqenet: Liqeni i Shkodres, Liqeni i Pogradecit, (Ohrit), Liqeni i Prespës.

Malet: Korabi, Tomori, Dajti, Sharri, Jabllanica, Bjeshkët e Nemuna etj.



(valuta e vendit ku jeton)

Aktivite:

1. Gjeneroni foto të qyteteve, të maleve, të lumenjve dhe të bregdetit shqiptar dhe bëni një album me titullin: "Shqipëria në sytë e mi". Prezantojeni albumin tuaj në klasë dhe bisedoni për te!
2. Krahasoni flamurin, valutën dhe pamjen e kryeqytetit të Shqipërisë me kryeqytetin e vendit ku jetoni!

17. KOSOVA



Para "NEWBORN"-it në Prishtinë

Republika e Kosovës gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik.

Kosova ka bukuri dhe pasuri të shumta natyrore: vargmale, lumenj, liqene, shpella dhe xehe të çmueshme. Është vendi i dytë në Evropë për rezerva të thëngjillit. Trepça është minierë nga e cila nxirret ari, argjendi, plumbi etj. Kosova ka edhe botë bimore e shtazore shumë të pasur.



Urë e vjetër në Prizren



Kristal nga miniera e pasur e Trepçës



Vargmalet e Sharrit janë zona më e pasur në Evropë me llojet e fluturave. Aty ekzistojnë më se 147 sosh. Paramendoni sa lloje të ngjyrave kanë ato!

Rezistenca paqësore 10 vjeçare e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova dhe sakrificat e popullit të Kosovës alarmuan botën për gjendjen e rëndë në vend.

Falë Luftës Çlirimtare të UÇK-së, të prirë nga komandanti Adem Jashari, dhe intervenimit ushtarak të NATO-s, Kosova fitoi lirinë e shumëpritur.



Pamje nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008

Fakte dhe shifra:

Sipërfaqja: 10.908 km² .

Popullsia: mbi 2 milionë banorë

Gjuha: shqipe, serbe, turke, boshnjake etj.

Valuta: Euro.

Kryeqyteti: Prishtina.

Qytetet kryesore: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjiçani, Mitrovica, Ferizaji.

Lumenjtë: Drini i Bardhë, Bistrica, Erenik, Ibri, Lepenci, Nerodimja etj.

Liqenet: Liqeni i Batllavës, Liqeni i Gazivodës, Liqeni i Badovcit, Liqeni i Radoniqit.

Malet: Sharri, Kopaoniku, Pashtriku, Bjeshkët e Nemuna, Qyqavica.

Bukuritë natyrore: Gryka e Rugovës, Ujvarat e Mirushës, Shpella e Gadimes, Brezovica etj.



*Ibrahim Rugova,
(1944-2006)*



*Adem Jashari,
(1955-1998)*

Republika e Kosovës ka një ekonomi të re. Ajo ka pasuri të shumta natyrore, por pasuria më e madhe e saj janë njerëzit, e posaçërisht rinia që përbën 60 % të popullsisë.

Aktivitete:


1. Gjeni foto nga qytetet, lumenjtë, malet dhe vendet me bukuri natyrore të Kosovës dhe bëni albumin tuaj "Kosova në sytë e mi". Prezantoni albumin në klasë dhe bisedoni për të!
2. Përmendni disa nga vendet e bukura të Kosovës që i keni vizituar. Në grupe nga dy prezantoni përshtypjet e njëri-tjetrit!
3. Mësoni më shumë për figurat që kontribuan për pavarësinë e Kosovës!

18. SHQIPTARËT NË MAQEDONI

Në Republikën e Maqedonisë shqiptarët janë popullsia e dytë për nga numri i banorëve. Ata jetojnë kryesisht në trojet e tyre etnike, të cilat me vendimin e Konferencës së Londrës 1913 mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë. Shumë shqiptarë të Maqedonisë, për shkaqe ekonomike e politike, gjatë dekadave, kanë emigruar në vende të ndryshme të botës.

Sot në Maqedoni shqiptarët janë popull shtetformues.

Qytetet në të cilat jetojnë shqiptarët janë: Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Dibra, Stuga, Kumanova etj.



Statuja e Nënës Tereze në Shkup



Kalaja e Shkupit

Shkupi është kryeqyteti i Maqedonisë.

Në të kaluarën ka qenë një nga qytetet e njohura ilire. Aty ishte ndërtuar kalaja e njohur ilire. Në Shkup gjendet monumenti -muzeu memorial kushtuar Nënës Tereze, shqiptares së njohur bëmirese, e cila ka lindur dhe ka kaluar fëmijërinë e saj në këtë qytet.



Nënë Tereze
(1910-1997)

Nënë Tereze u lind në Shkup. Si e vogël quhej Gonxhe Anjeze Bojaxhiu. Rrjedh nga një familje shqiptare nga rrethi i Mirditës, që kishin ardhur për të jetuar në Shkup. Gonxhja kishte dashur të bëhej mësuese, poete dhe të kompozonte muzikë. Në moshën 18 vjeçare vendosi për t'u bërë motër nderi në Institutin e së Lumes Zojë, që njihej ndryshe me emrin “Motrat e Loretos”, në Irlandë. Më 1979 Nënë Tereze mori çmimin Nobel për Paqe. Me atë rast ajo theksoi publikisht: **“Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri”**.



Monument kulturor/historik në Tetovë



Kërçova, ish qyteti i vjetër ilir Uskana



Pamje e Gostivarit

Aktivitete:

1. Gjeni foto dhe informata për qytetet dhe fshatrat ku jetojnë shqiptarët në Maqedoni! Bëni një album dhe prezentoni punën tuaj në klasë!
2. Mësoni më shumë për historinë e Shkupit dhe për Nënë Tereze!
3. Nëse në vendin ku jetoni, ose në klasën tuaj ka shqiptarë nga Maqedonia, bisedoni më shumë për vendlindjen e tyre!

19. DIASPORA SHQIPTARE



Veprimtari të shkollës shqipe në Gjenevë

Në të kaluarën, shumë shqiptarë u detyruan të largoheshin nga trojet e tyre. Arsyet ishin të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, ata kanë shkuar në vende të tjera për shkak të kushteve ekonomike dhe politike. Për emigrimin populli që moti ka krijuar këngë, të cilat njihen si “Këngë të kurbetit”. Ato janë plot dhimbje dhe mall për Atdheun.

Emigrimi i parë më i madh i shqiptarëve nga trojet e tyre ka ndodhur pas vdekjes së Skënderbuet (shek. XV). Ata u vendosën kryesisht në brigjet e Italisë, në Sicili dhe në Kalabri. Shumë nga poetët, artistët dhe veprimtarët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishin të mërguar në vende të ndryshme të botës, si në Rumani, në Turqi, në Egjipt etj. Dëbimet dhe shpërnguljet e shqiptarëve me dhunë nga trojet e tyre kanë vazhduar edhe më vonë nga pushtetet okupuese. Përveçse në Turqi shqiptarët kanë emigruar edhe në Evropë, Amerikë, Australi etj.

Fillimisht emigruan burrat, ndërsa familjet (gratë e fëmijët dhe anëtarët e tjerë) kanë qëndruar në trojet e tyre, duke vuajtur me mall mungesën e anëtarit të familjes. Ndërkohë, familjarët e shpërngulur kanë marrë me vete edhe gratë dhe fëmijët e tyre. Një dëbim të plotë të dhunshëm të shqiptarëve nga Kosova u përpoq ta bënte Serbia në vitet 1998-1999. Mirëpo, për fat nuk ia doli dhe kjo fushatë e egër u ndal në saje të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të përkrahjes së saj nga NATO-ja.

Mërgimtarët shqiptarë janë të organizuar në shoqata, shoqëri dhe në klube të ndryshme kulturore e sportive. Ata vazhdimisht kultivojnë ndjenjën e përkatësisë së tyre kombëtare, duke organizuar aktivitete të ndryshme kulturore.

Mërgimi sot domosdoshmërisht nuk konsiderohet aq i rëndë si më parë. Shumë të rinj

vazhdojnë shkollimin në vende të ndryshme.

Familjet shqiptare që jetojnë në mërgim vazhdimisht synojnë të integrohen në shoqëritë e vendeve ku jetojnë. Shumë prej tyre kanë shtetësinë e atyre vendeve. Mërgimtarët shqiptarë punojnë edhe në institucionet e vendit ku kanë emigruar. Disa nga ta kanë krijuar bizneset e tyre. Fëmijët shkojnë në shkollë dhe jetojnë sikurse fëmijët e popujve të tjerë, që jetojnë në ato vende.

Shqiptarë të emigruar ka në Greqi, Gjermani, Zvicër, Amerikë, Itali dhe në vende të tjera të botës.

Këta shqiptarë rëndom kanë shtetësi shqiptare, por edhe shtetësi të vendeve ku jetojnë. Ata flasin disa gjuhë botërore dhe kjo u jep përparësi në punë dhe në jetë.

Por shqiptarët nuk e harrojnë kurrë atdheun e tyre. Sa herë që u jepet mundësia, ata vijnë për pushime dhe vizita në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni e në vende të tjera ku jetojnë të afërmit e tyre. Shkolla e mësimit shqip në diasporë, po ashtu, ndihmon që fëmijët e këtyre familjeve, që lindin e rriten në vende të ndryshme, të mësojnë gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre kombëtare.



Aktivitete:

1. Bisedoni në klasë dhe me prindër për familjen tuaj dhe të shqiptarëve të tjerë që jetojnë në afërsi ! Kur janë shpërngulur ata në këtë vend dhe nga cilat troje shqiptare kanë ardhur?
2. Si janë të organizuar shqiptarët në qytetin ku jeton ti? A ka në qytetin tuaj shoqata kulturoro-artistike, ku tubohen shqiptarët për aktivitete të ndryshme?
3. Nëse merrni pjesë në ndonjë aktivitet kulturor, shpalosni përshtypjet me shoqe e shokë!

20. ARTI DHE KULTURA SHQIPTARE SOT

Arti dhe kultura shqiptare kanë arritur rezultate të shumta, përkundër vështirësive nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare. Në shumë vende të botës sot me sukses prezentohen grupe artistike, ekspozita, orkestra, ansamble muzikore dhe krijues të ndryshëm individual. Në Shqipëri, në Kosovë, por edhe në viset e tjera ku jetojnë shqiptarët, ekzistojnë institucione kulturore e artistike të cilat me sukses shfaqin vlerat kulturore e tradicionale shqiptare.

Artet figurative

Në pikturë, në skulpturë dhe në artet e tjera pamore, artistët shqiptarë po arrijnë rezultate të mira. Në galeritë dhe në muzeumet e qyteteve shqiptare sot organizohen ekspozita të shumta të artistëve tanë dhe të huaj.

Në Shqipëri, në Kosovë dhe në vendet e tjera të banuara me shqiptarë sot ka institucione për shkollimin e artistëve të rinj.



Ibrahim Kodra
(1918-2006)

Ibrahim Kodra, piktor i shquar shqiptar, lindi në Ishëm të Durrësit. Pasi fitoi një bursë nga mbreti Ahmet Zogu për studime në Itali, ai ngeli të jetojë dhe të veprojë atje. Që nga viti 1944, kur e hapi ekspozitën e parë personale në Milano, punimet e tij u ekspozuan në galeritë dhe në muzetë më të njohura të botës. Ka marrë shumë çmime, ndër të cilat edhe “Nderi i Kombit”. Njihet për stilin e tij të veçantë në pikturë.



Ibrahim Kodra:
Muzikantët



Galeria e Arteve-Tiranë



Agim Salihu: *Demi i thyer*

Muzika popullore është një thesar i çmueshëm i kulturës shqiptare. Ajo vazhdon të kultivohet brez pas brezi, duke ruajtur veçoritë e saj karakteristike në treva të ndryshme. Këndimi i jugut shqiptar iso-polifonik (në shumë zëra) njihet sot në gjithë botën. Ky këndim është një vlerë universale, e mbrojtur nga UNESCO-ja si trashëgimi e veçantë botërore e njerëzimit. Edhe këngët kreshnike të veriut me lahutë e çifteli janë një pasuri e vlefshme. Këngët popullore qytetare, të shoqëruara me instrumente popullore, këndohen edhe sot. Pjesë e rëndësishme e kësaj pasurie janë edhe vallet popullore shqiptare. Sot ka shumë festivale të muzikës popullore shqipe, në Shqipëri, në Kosovë dhe në viset e tjera.

Festivalet më të njohura të folklorit shqiptar mbeten në Gjirokastrë, në Korçë, në Lezhë, në Elbasan, në Vlorë, në Përmet, në Tropojë, në Peshkopi, në Drenas etj.

Muzika artistike shqiptare ka përjetuar po ashtu një zhvillim të konsiderueshëm. Teatri i Operas dhe Baletit në Shqipëri, Orkestra Simfonike e Shqipërisë, Filharmonia e Shqipërisë, Filharmonia e Kosovës janë institucionet qendrore të muzikës artistike. Krahas interpretimit të veprave muzikore botërore, aty promovohen edhe të arriturat e muzikës artistike shqiptare. Janë krijuar vepra të shumta të muzikës artistike, duke përfshirë edhe disa opera. Opera e parë shqiptare “Mrika” është kompozuar nga Prenkë Jakova në vitin 1958. Në shumë shkolla të muzikës në Shqipëri e në Kosovë shkollohen shumë muziktarë të rinj. Disa ish nxënës/e të këtyre shkollave sot janë artistë të shquar muzikorë në vende të ndryshme të botës, si Inva Mula e Ermonela Jaho (soprano), Saimir Pirgu (tenor), Tedi Papavrami (violinist), etj.



Inva Mula

Inva Mula (1963) është këngëtare e shquar e operas. Ajo ka kënduar në shumë shfaqje operistike anembanë botës, në Milano, Muni, Oslo, Tokio etj. Rolet e saj përfshijnë personazhet nga operat e kompozitorëve më të njohur, si Verdi, Pucini, Zhorzh Bize, etj.



Muzika argëtuese në viset shqiptare ndjek hapat dhe trendet e muzikës së popullarizuar në botë. Shquhen disa këngëtarë dhe grupe muzikore që këndojnë këngë të zhanreve të ndryshme. Si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë organizohen festivalet e këngës argëtuese shqiptare në të cilat prezentohen shumë talente të reja.



Baleti shqiptar, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, shënoi suksese. Tanimë janë shkruar disa vepra muzikore për balet nga kompozitorë shqiptarë, si: “Halili e Hajria” kompozuar nga Tish Daia, “Sokoli e Mirusha” kompozuar nga Akil Koci, “Delina” nga Cesk Zadeja, “Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë” me muzikë të Feim Ibrahimit nga libri i Ismail Kadaresë dhe me koreografi të Agron Aliajt etj.



Pulla postale nga Baleti i parë shqiptarë ‘Halili dhe Hajria’



Shfaqjet **teatrale** e **filmike** në qytetet shqiptare janë të shumta. Pothuajse çdo qytet e ka teatrin e vet ku organizohen festivale të teatrit dhe të filmit shqiptar, Në to cilat marrin pjesë edhe artistë nga shtete të tjera.



Bekim Fehmiu në një skenë filmi (1936-2010)

Bekim Fehmiu ishte aktor i njohur filmi. Ai u bë i famshëm me rolin e tij në filmin “Mbledhësit e puplave” (1966) e pastaj shumë më tepër me filmin “Odisea”. Ishte aktori i parë shqiptar, i cili depërtoi fuqishëm në kinematografinë botërore. Ka interpretuar role të shumta me aktorë të njohur botërisht, si John Huston, Ava Gardner, Irene Papas, Claudia Cardinale etj.

Letërsia shqiptare paraqet një thesar të rëndësishëm kulturor. Ajo ka shënuar rezultate në të gjitha llojet letrare si në poezi, në tregim, novelë, roman e dramë. Veprat e disa autorëve të njohur janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera. Sot janë me mijëra botime të cilat i pasurojnë bibliotekat dhe libraritë e shumta. Çdo vit në Kosovë e në Shqipëri organizohen panairët e librit ku prezentohen botimet më të reja të shtëpive botuese.



Ismail Kadare

Ismail Kadare, shkrimtari më i shquar shqiptar, lindi në Gjirokastrë më 1936. Veprat e tij janë përkthyer në afro 30 gjuhë të botës. Disa herë është nominuar për Çmimin Nobel për letërsi. Kadare ka marrë shumë çmime të tjera të rëndësishme letrare. Ndër veprat e tij më të njohura janë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Prilli i thyer”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndërrave”, “Kush e solli Doruntinën” etj. “Princesha Argjiro”, është poema e tij e njohur për fëmijë.

Aktivitete:

1. Gjatë vizitave nëpër viset shqiptare, vizitoni galeritë, muzetë, teatrot dhe kinematë! Bisedoni e shkruani për përshtypjet!
2. Bëni një album me këngëtarë, piktorë, aktorë e shkrimtarë që i pëlqeni!
3. Në grupe nga dy në klasë përgatitni një prezentim me slajde e fotografi për ndonjë nga këto personalitete dhe diskutoni për to!
4. Gjeni ndonjë personalitet/e të shquar shqiptar/e në vendin ku jetoni! Mësoni më shumë për profesionin e saj/tij!
5. Nëse në afërsi gjindet ndonjë përmendore apo ndonjë shtëpi muze, ku ka jetuar ndonjë personalitet/e shqiptar, organizoni një vizitë bashkë me shokët dhe shoqet e klasës!





Muhamet Ahmeti-Metis, Lush Culaj, Besa Luzha, Xhevat Sylja
SHQIPTARËT - HISTORIA DHE TROJET
Fletore tematike - për nivelin e dytë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në prill 2012

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

94(=18)(076.1)

008(=18)

Shqiptarët historia dhe trojet: fletore tematike për nivelin e dytë / Muhamet Ahmeti-Metis... [et al.]. - Botimi i parë. - Pejë: Dukagjini, 2012. - 52 f.: ilustr. me ngjyra; 30 cm.

1. Ahmeti, Muhamet

ISBN 978-9951-05-247-4

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr. 813-304, të datës 14.02.2012.*